



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 23.05.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje Data Center Primar dhe Data Center sekondar”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
(Mirëmbajtja e sotwarëve tw teknologjisë së informacionit. _50000000-5)**

VLERA E FONDIT LIMIT: 17,976,000 (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë, pa TVSH.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: Afati i ofrimit të shërbimit **12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarikë** nga data e lidhjes së kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces 1;

b. Lista e çmimeve të Shërbimeve, sipas Shtojces 2;

c. Sigurimin e Ofertës, në vlerën 359,520 Lek (treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e dyqind) sipas Shtojcës 3;

ç. Formulari i Informacionit Konfidencial, sipas Shtojcës 4;

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar)

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 95% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysht objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik konkurues duhet të jete i certifikuar me :

- ISO 9001 ose ekuivalente, (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)
- ISO/IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente, (për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit).
- ISO 27001 ose ekuivalente, (për Sigurinë e Informacionit)

Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë të pakten në datën e hapjes së ofertave.

Ne rast se OE janë pjesëmarrës në tendër si bashkim operatorësh, secili anetar duhet të paraqesë ISO në përputhje me zërat që do të marrë përsipër të furnizoje.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryeje realizimin e kontratës objekt prokurimi në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.

Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryeje realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendësi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara si dhe aksesimi mbi to të jetë i verifikueshem e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontratë do ketë mirëmbajtje e upgrade të sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim.

Certifikimi **ISO 20001-1:2011** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryeje realizimin e kontratës objekt prokurimi duke qenë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në terësi i cili është terësisht i bazuar në produkte TIK (softëare dhe hardëare);

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar për instalimin, implementimin, dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve ekzistuese.

Në përbërje të stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë:

- a) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi FUJITSU për Server-at për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
- b) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional” ose ekuivalente nga prodhuesi FUJITSU për Virtualizimin e Serverave për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
- c) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi DELL për Server-at për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.
- d) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi DELL për Storage.
- e) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional” ose ekuivalente nga prodhuesi VMËARE për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese.

- f) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi Juniper për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese për pajisjet e rrjetit.
- g) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel Profesional “CCNP” për sigurinë ose ekuivalente nga prodhuesi CISCO për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese Adaptive Security Appliance (ASA).
- h) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar nga prodhuesi Veeam për të instaluar, implementuar dhe mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese Veeam Backup & Replication.
- i) Të pakten 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional ose ekuivalente nga prodhuesi HPE për servera për të mirëmbajtur zgjidhjen ekzistuese

Për të gjithë punonjësit e mesipërm, duhet të paraqiten certifikatat përkatëse si dhe operatori ekonomik duhet të vërtetojë se i ka të punësuar për një periudhë jo më pak se 2-muj nga data e hapjes së tenderit. Një punonjës mund të ketë një ose disa certifikime, për të përmbushur kriteret e mesipërme për certifikimet. Për këtë qëllim operatori ekonomik duhet të paraqesi:

- Certifikatat përkatëse për secilin nga specialistët e mesipërm;
- Listëpagesat e dorëzuara nepërmjet formës elektronike në organet kompetente, për 2 muajt e fundit;
- Vërtetim nga organet tatimore përkatëse për numrin total mujor të punonjësve të siguruar të paktën për 2 muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 pika 4 paragrafet b) dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.

Konkretisht:

- 1) Për kriterin në pikën **a)** duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese të implementuara në DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e serverave FUJITSU, dhe për këtë zgjidhje të meparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkohet 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për server FUJITSU, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese FUJITSU.
- 2) Për kriterin në pikën **b)** duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese të implementuara në DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e serverave të virtualizuar FUJITSU, dhe për këtë zgjidhje të meparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkohet 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për VIRTUALIZIM server FUJITSU, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese FUJITSU.
- 3) Për kriterin në pikën **c)** duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese të implementuara në DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e serverave DELL, dhe për këtë zgjidhje të meparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkohet 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për server DELL, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese DELL.

- 4) Për kriterin në pikën **d**) duke qene se nga zgjidhjet ekzistuese te implementuara ne DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e storage DELL, dhe për këtë zgjidhje të mëparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkojmë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për storage DELL, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese DELL.
- 5) Për kriterin në pikën **e**) duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese te implementuara ne DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e virtualizimit VMËARE, dhe për këtë zgjidhje të mëparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkojmë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për VMËARE, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese.
- 6) Për kriterin në pikën **f**) duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese të implementuara në DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar ne teknologjine e sëitch JUNIPER, dhe për këtë zgjidhje të mëparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkojmë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për JUNIPER, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese JUNIPER.
- 7) Për kriterin në pikën **g**) duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese te implementuara ne DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e fireëall CISCO ASA, dhe për këtë zgjidhje të mëparshme kritike me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkojmë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për sigurinë CISCO, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese CISCO ASA.
- 8) Për kriterin në pikën **h**) duke qene se nga zgjidhjet ekzistuese te implementuara ne DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e backup VEEAM, dhe për këtë zgjidhje të mëparshme me vlerë investimi të konsiderueshme kërkohet mirëmbajtje, upgrade dhe ri-konfigurime, atëherë kërkojmë 1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për softëare VEEAM, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja dhe implementimi i saktë i ndryshimeve nëkonfigurime të zgjidhjes ekzistuese VEEAM.
- 9) Për kriterin në piken **i**) duke qenë se nga zgjidhjet ekzistuese të implementuara ne DataCenter Posta Shqiptare është e bazuar në teknologjinë e serverave Heëlett Packard Enterprise (HPE), dhe për këtë zgjidhje të mëparshme me vlerë investimi të konsiderueshme, atëherë kërkojmë1 (një) specialist të certifikuar në nivel profesional për server HPE, në mënyrë që të garantohet mirëmbajtja e saktë në punë e zgjidhjes ekzistuese HPE.

Operatori i huaj ekonomik duhet t'i plotësoje të gjitha kushtet e mesipërme duke paraqitur dokumentat përkatëse lëshuar nga institucionet përgjegjëse në shtetin e tyre konform ligjive në fuqi.

Sqarim! Të gjitha kriteret e sipërcituara në **Shtojca 8, të DST-së**, të cilat përfshihen në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të*

treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojca 9, të DST-së, do të vlerësohen të përmbushura në fazën e vlerësimit të ofertave të ofertuara në SPE.

Referuar përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, si dhe përcaktimet e pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Ofertuesi fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak duhet të paraqesë në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për

“Mirëmbajtje Data Center Primar dhe Data Center Sekondar”

Qëllimi i këtij projekti është mirëmbajtja e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për të garantuar vazhdueshmërinë e shërbime ndaj përdoruesve. Për të arritur këtë qëllim duhen realizuar objektivat si më poshtë:

- Mirembajtja e paisjeve ne Primary Site per performace maksimale.
- Mirembajtja e paisjeve ne Disaster Recovery Site per performace maksimale.

Objekti kryesor i këtij shërbimi, është përmirësimi i infrastrukturës hardware, software si dhe i optimizimit të infrastrukturës me disponueshmeri të lartë për të gjithë shërbimet, duke realizuar shërbimet si më poshtë:

- Mirembajtja dhe konfigurimi e infrastrukturës hardware aktuale bazuar saktësisht në kërkesat funksionale dhe specifikimet teknike;
- Respektimi i parimit të konfidencialitetit të të dhënave;
- Testimi i përgjithshëm i sistemeve;

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

NJËSIA E PROKURIMIT